

**KOMBET E
BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen
Penale të Personave Përgjegjës për
Shkelje të Rënda të së Drejtës
Humanitare Ndërkombëtare të Kryera
në Territorin e ish-Jugosllavisë prej
Vitit 1991

Lënda Nr. IT-04-84bis-PT

Data: 8 dhjetor 2010

Originali: anglisht

NË DHOMËN GJYQËSORE II

Para: Gjykatësit Bakone Justice Moloto, Kryegjykatës
Gjykatësit Burton Hall
Gjykatësit Guy Delvoie,

Sekretari: Z. John Hocking

Vendim: 8 dhjetor 2010

PROKURORI

kundër

**RAMUSH HARADINAJT
IDRIZ BALAJT
LAHI BRAHIMAJT**

PUBLIK

**VENDIM MBI MOCIONIN E RAMUSH HARADINAJT PËR LIRIM TË
PËRKOHSHËM**

Zyrës së Prokurorit:

Z. Paul Rogers

Avokatëve të Mbrojtjes:

Z. Ben Emmerson QC dhe Z. Rodney Dixon për Ramush Haradinajn
Z. Gregor Guy-Smith dhe Zj. Colleen Rohan për Idriz Balajn
Z. Richard Harvey dhe Z. Paul Troop për Lahi Brahimajn

KJO DHOMË GJYQËSORE e Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Të Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991 (“Tribunali”) ka marrë “Mocionin në emër të Ramush Haradinajt për Lirim të Përkohshëm me Kusht Gjatë Pushimeve Dimërore të Gjykatës” dorëzuar më 26 nëntor 2010 (“Mocioni”);

A. HISTORIA PROCEDURALE

1. Më 21 korrik 2010 Dhoma e Apelit shfuqizoi vendimin e Dhomës Gjyqësore për dhënien e pafajësisë Ramush Haradinajt (“I Akuzuari”), Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt për disa pika të Aktakuzës dhe urdhëroi rigjykimin e tyre për këto pika¹. Dhoma e Apelit gjithashtu urdhëroi mbajtjen në paraburgim të Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt dhe urdhëroi Komandantin e Njësisë së Paraburgimit të Kombeve të Bashkuara që t’i mbante të paraburgosur deri në një urdhër tjetër².

2. Më 26 nëntor 2010 i Akuzuari dorëzoi “Mocionin në emër të Ramush Haradinajt për Lirim të Përkohshëm me Kusht Gjatë Pushimeve Dimërore të Gjykatës” (“Mocion”). Më 3 dhjetor 2010 Prokuroria dorëzoi “Përgjigje e Prokurorisë ndaj Mocionit të Dytë të Ramush Haradinajt për Lirim të Përkohshëm” (“Përgjigje”). Më 7 dhjetor 2010 i Akuzuari dorëzoi “Kundërpërgjigje ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Mocionit të Ramush Haradinajt për Lirim të Përkohshëm me Kusht Gjatë Pushimeve Dimërore të Gjykatës” (“Kundërpërgjigje”).

3. Më 3 dhjetor 2010 Ministria e Punëve të Jashtme holandeze dorëzoi një letër. Më 29 nëntor 2010 Dhoma Gjyqësore nxori “Kërkesë drejtuar EULEX-it për Parashtrime mbi Mocionin e Ramush Haradinajt për Lirim të Përkohshëm me Kusht”. Më 6 dhjetor 2010 EULEX-i dorëzoi përgjigjen.

B. PARASHTRIMET

1. Mocioni

¹ Aktgjykimi i Apelit, para. 377. Dhoma e Apelit urdhëroi rigjykimin e të Akuzuarit dhe Idriz Balajt për pikat 24, 26, 28, 30, 32 dhe 34 të Aktakuzës dhe rigjykimin e Lahi Brahimajt për pikat 24, 26, 30 dhe 34 të Aktakuzës.

² Aktgjykimi i Apelit, para. 377.

4. I Akuzuari kërkoi të lirohet përkohësisht me kusht gjatë pushimeve dimërore të gjykatës, prej të premtes 17 dhjetor 2010 deri të premten, 14 janar 2011 ose për çfarëdo periudhe të kufizuar që Dhoma Gjyqësore do ta gjykojë të përshtatshme.³ I Akuzuari parashtron se bashkëshortja e tij pritet të lindë fëmijën e tyre afërsisht në mes të janarit 2011, dhe se ai dëshiron të jetë pranë saj në periudhën e paralindjes dhe në qoftë se është e mundshme, edhe në lindjen e fëmijës.⁴

5. I Akuzuari parashtron se EULEX-i mund të ofronte garanci me kushtet e kërkuara në kërkesën e tij për lirim të përkohshëm të 26 korrikut 2010⁵ dhe se të njëjtat garanci mund të vlenin për çfarëdo periudhe të lirim të përkohshëm me kusht urdhëruar prej Dhomës Gjyqësore, duke qenë se kushtet e kërkuara prej të Akuzuarit janë të njëjta me përjashtim të faktit se ai nuk kërkon të shkojë në Gllogjan.⁶

6. I Akuzuari deklaroi se në “Vendim mbi Mocionin e Ramush Haradinajt për Lirim të Përkohshëm” lëshuar më 10 shtator 2010 (Vendim i shtatorit 2010”) Dhoma Gjyqësore shprehu qartësisht pikëpamjen se i Akuzuari nuk përbente rrezik arratisjeje dhe se ai “nuk përbën rrezik personal ndaj sigurisë së cilësdo viktime, dëshmitari apo individi tjetër”.⁷ Ai argumenton se çfarëdo rrezik për komprometimin e procesit identifikuar prej Dhomës Gjyqësore, do të zvogëlohej mjaftueshëm në qoftë se kërkesa e tij e kufizuar do të miratohej në këtë fazë dhe se çfarëdo rrezik i mundshëm ndaj dëshmitarëve që mund të lindë prej lirim të përkohshëm për një periudhë të zgjatur deri në fillimin e gjykimit, konstatuar prej Dhomës Gjyqësore në Vendimin e saj të shtatorit 2010, do të minimizohej mjaftueshëm prej urdhrin për lirim të përkohshëm me kusht për një periudhë shumë të kufizuar, duke marrë parasysh rrethanat e tij të tanishme familjare.⁸

7. I Akuzuari e nxiti Dhomën Gjyqësore t’i kushtojë rëndësi kohës që i Akuzuari ka kaluar deri tani në paraburgim gjatë shqyrtimit të argumentit të tij se lirimi për një periudhë të shkurtër nuk duhet refuzuar për të njëjtat arsye si lirimi i përkohshëm paragjyqësor deri në fillim të gjykimit.⁹ Ai argumenton se një faktor tjetër në dobi të lirim të përkohshëm është

³ Mocion, para. 2.

⁴ *Po aty.*, para. 9.

⁵ Mocion në Emër të Ramush Haradinajt për Lirim të Përkohshëm, 26 korrik 2010.

⁶ *Po aty.*, para. 7.

⁷ *Po aty.*, para. 9.

⁸ *Po aty.*, para. 10.

⁹ *Po aty.*, para. 12.

bashkëpunimi i plotë i të Akuzuarit me Tribunalin dhe Njësinë e Paraburgimit të Kombeve të Bashkuara (“NJPKB”) gjatë procesit të tanishëm dhe të mëhershëm.¹⁰

2. Përgjigje

8. Prokuroria argumenton se “asgjë nuk ka ndryshuar” që prej Vendimit të shtatorit 2010 kur Dhoma Gjyqësore rrëzoi kërkesën e të Akuzuarit për lirim të përkohshëm sepse rrezikonte komprometimin e procesit.¹¹

9. Prokuroria argumenton se frikësimi i dëshmitarëve mbetet dukuri mbizotëruese në Kosovë,¹² dhe kjo konfirmohet prej Raportit të Komisionit Evropian mbi Përparimin në Kosovë i vitit 2010, publikuar më 9 nëntor 2010.¹³ Gjithashtu Prokuroria argumenton se që kur u urdhërua rigjykimi, ajo ka ndeshur në vështirësi për ti bindur dëshmitarët brenda dhe jashtë Kosovës që të dëshmojnë.¹⁴

10. Sipas Prokurorisë lirimi me kusht, edhe pse i përkohshëm, do të përkeqësojë atmosferën tashmë të gjithanshme të frikësimit të dëshmitarëve dhe në fund të fundit do të rrezikojë të komprometojë procesin dhe kjo është sidomos e vërtetë në fazën e tanishme në vigjilje të fillimit të rigjykimit.¹⁵ Prokuroria parashtron pasqyrimi më i madh në media për shkak të lirimimit të përkohshëm të të Akuzuarit pak para fillimit të rigjykimit, do të dëmtojë zbulimin e të vërtetës prej Dhomës Gjyqësore.¹⁶

11. Prokuroria deklaron se i Akuzuari është ende emër mjaft i shquar në Kosovë dhe se ai do të jetë më shumë në qendër të vëmendjes gjatë periudhës së afërme zgjedhore¹⁷ dhe se në këtë kontekst politik vendimi për të liruuar të Akuzuarin do të tërhiqte vëmendjen e medias, duke kontribuar në këtë mënyrë në atmosferën e frikësimit të dëshmitarëve dhe në inkurajimin e përkrahësve të të Akuzuarit për kryerjen e akteve të frikësimit.¹⁸

¹⁰ *Po aty.*, para. 14.

¹¹ *Përgjigje*, para. 1.

¹² *Po aty.*, para. 3.

¹³ *Po aty.*, para. 5.

¹⁴ *Po aty.*, para. 7.

¹⁵ *Po aty.*, para. 7.

¹⁶ *Po aty.*, para. 7.

¹⁷ *Po aty.*, para. 8.

¹⁸ *Po aty.*, para. 8.

12. Sipas argumentit të Prokurorisë, kohëzgjatja e kufizuar e lirimit të përkohshëm nuk e pakëson automatikisht rrezikun për komprometimin e procesit dhe rrethanat e tanishme janë të ndryshme nga ato kur i Akuzuari u lirua për dy javë gjatë pushimeve dimërore të vitit 2007 për arsye se së shpejti fillon rigjykimi gjatë të cilit do të dëshmojnë dëshmitarë.¹⁹ Prokuroria konkludon se në kuadër të masave kundër frikësimit të dëshmitarëve dhe për garantimin e ndershmërisë së procesit, Dhoma Gjyqësore duhet të ushtroje kompetencën e vetë gjykuese duke e rrëzuar Mocionin.²⁰

13. Gjithashtu Prokuroria parashtron se lirimi i përkohshëm nuk duhet miratuar në qoftë se EULEX-i nuk konfirmon se do të garantojë përmbushjen e kushteve të lirimit të përkohshëm,²¹ dhe kërkon që në rast se lirimi i përkohshëm miratohet, ai të pezullohet në bazë të Rregullës 65(E) të Rregullores së Procedurës dhe Provave (“Rregullorja”).²²

3. Kundërpërgjigje

14. I Akuzuari kërkoi leje për kundërpërgjigje.²³ Ai parashtron se në Përgjigje Prokuroria nuk paraqiti prova në mbështetje të pretendimit se edhe sikur i Akuzuari të lirohet përkohësisht për një periudhë të shkurtër gjatë pushimeve dimërore, ai do të përbënte rrezik për dëshmitarët.²⁴ I Akuzuari parashtron se në deklaratën në Shtojcën B të Përgjigjes e cila është mjaft e përgjithshme, ose në çfarëdo materiali tjetër të paraqitur prej Prokurorisë, nuk ka prova se rreziku që pretendohet, do të shtohet ose do të përkeqësohet si rezultat i periudhës shumë të shkurtër të lirimit të përkohshëm kërkuar prej të Akuzuarit.²⁵ Ai deklaron se Raporti i Komisionit Evropian i vitit 2010 mbi Përparimin në Kosovë i publikuar më 9 nëntor 2010,²⁶ nuk mund të përdoret për nxjerrjen e konkluzionit se dëshmitarët e kësaj çështjeje do të rrezikoheshin prej lirimit të përkohshëm të të Akuzuarit.²⁷ Gjithashtu ai argumenton se nuk është paraqitur asnjë provë për sa i përket lidhjes midis informacionit të mundshëm në gazeta dhe shtimit të rrezikut të dëshmitarëve në këtë çështje.²⁸ Ai konkludon se pretendimi i

¹⁹ *Po aty.*, para. 11. Vendim mbi Mocionin në emër të Ramush Haradinajt për Lirim të Përkohshëm, 14 dhjetor 2007, para. 21.

²⁰ Përgjigje, para. 13.

²¹ *Po aty.*, para. 14.

²² *Po aty.*, para. 15.

²³ Kundërpërgjigje, para. 1.

²⁴ *Po aty.*, para. 2.

²⁵ *Po aty.*, para. 4, 5.

²⁶ Përgjigje, Shtojca A.

²⁷ Kundërpërgjigje, para. 6.

²⁸ *Po aty.*, para. 9.

Prokurorisë për shtimin e rrezikut ndaj dëshmitarëve të kësaj çështjeje për arsye të lirimit të përkohshëm me kusht nuk vërtetohet prej provave.²⁹

4. Letra e EULEX-it

15. Në letrën e 6 dhjetorit 2010, EULEX-i konfirmoi se ishte i gatshëm dhe në gjendje të merrte përsipër përgjegjësitë në lidhje me lirimin e përkohshëm të të Akuzuarit kërkuar në Mocion.³⁰ Gjithashtu letra tërhoqte vëmendjen në lidhje me faktin e karakterit evolues të rolit të EULEX-it në Kosovë ku pohohej se megjithëse mbante kompetenca ekzekutive në lidhje me hetimin e krimeve dhe procese gjyqësore të krimeve të luftës, mandati i tij nuk ishte aq i gjerë sa ai i pranisë së mëparshme ndërkombëtare të mëparshme administruar prej UNMIK-ut.³¹

C. LIGJI PËRKATËS

16. Rregulla 65 parashtron kushtet mbi bazën e të cilave një Dhomë Gjyqësore mund të urdhërojë lirimin e përkohshëm të të akuzuarit. Rregulla 65 është e vlefshme si para gjykimit po ashtu edhe gjatë procesit gjyqësor. Në pjesën përkatëse të Rregullës 65 lexohet:

(A) Pas paraburgimit, i akuzuari nuk mund të lirohet veçse me urdhër të një Dhome.

(B) Dhoma Gjyqësore mund të urdhërojë lirimin vetëm u pasi jep mundësinë për të shprehur mendimin vendit pritës dhe shtetit në të cilin i akuzuari kërkon të lirohet, dhe vetëm nëqoftëse bindet se i akuzuari do të paraqitet në gjyq dhe se, po të lirohet, nuk do të përbëjë rrezik për asnjë viktimë, dëshmitar, ose person tjetër.

(C) Dhoma Gjyqësore mund të vendosë kushte që i gjykon të nevojshme për lirimin, ndër të cilat përmbushjen e një fletëgarancie dhe respektimin e kushteve të nevojshme që mundësojnë praninë e të akuzuarit në procesin gjyqësor si edhe mbrojtjen e të tjerëve.

17. Rregulla 65 (E) më tej parashtron se Prokurori mund të kërkojë pezullimin e një vendimi nga Dhoma Gjyqësore për lirimin e një të akuzuari me arsyetimin se Prokurori synon të apelojë vendimin dhe bën një kërkesë të tillë në kohën kur dorëzon përgjigjen e tij ose të saj ndaj kërkesës fillestare prej të akuzuarit për lirim të përkohshëm.

D. DISKUTIM

1. A do të paraqitet i Akuzuari në gjykim

²⁹ *Po aty.*, para. 11.

³⁰ Letër e EULEX-it, f. 1.

³¹ *Po aty.*, f. 2.

18. Në Vendimin e shtatorit 2010, Dhoma Gjyqësore konstatoi se nuk kishte asnjë arsye për të menduar se ekzistonte rreziku që i Akuzuari të mos i dorëzohej Tribunalit kur të urdhërohej në lidhje me këtë.³² Që prej Vendimit të shtatorit 2010 nuk është paraqitur asnjë provë që tregon se në qoftë se do të lirohej, i Akuzuari nuk do të paraqitej në gjykim. Për më tepër EULEX-i ka pohuar se është i gatshëm dhe në gjendje të marrë përsipër përgjegjësitë në lidhje me lirimin e përkohshëm të Akuzuarit kërkuar në Mocion.³³ Dhoma Gjyqësore është e bindur se i Akuzuari do të paraqitet në gjykim.

2. Në rast të lirimit të tij, a do të përbëjë i Akuzuari rrezik për ndonjë viktimë, dëshmitar ose individ tjetër

19. Në Vendimin e shtatorit 2010, Dhoma Gjyqësore konkludoi se i Akuzuari personalisht nuk paraqet rrezik për sigurinë e ndonjë dëshmitari, viktime apo individ tjetër.³⁴ Sërish që prej atij Vendimi nuk është paraqitur asnjë provë që tregon të kundërtën. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore është e bindur se në qoftë se lirohet i Akuzuari nuk do të përbëjë rrezik ndaj ndonjë viktime, dëshmitari apo individ tjetër.

3. Ushtrimi i kompetencës për miratimin ose mosmiratimin e lirimit të përkohshëm

20. Dhoma Gjyqësore ka kompetencë të mos miratojë lirim të përkohshëm kur është e bindur se janë përmbushur dy kushtet e parashtruara në Rregullën 65 (B), dhe në marrjen e vendimit për ushtrimin e kësaj kompetence, Dhoma Gjyqësore duhet t'i marrë parasysh të gjithë faktorët e rëndësishëm të çështjes.³⁵ Më tej Dhoma Gjyqësore do të shqyrtojë nëse do ta ushtrojë këtë kompetencë.

21. Nuk ka arsye të mendohet se që prej vendimit të shtatorit 2010 atmosfera e frikësimit të dëshmitarëve është përmirësuar. Gjatë procesit gjyqësor mbizotëronte një atmosferë e pashoqe e frikësimit të gjithëpranishëm dhe të rëndë të dëshmitarëve.³⁶ Frikësimi i dëshmitarëve mbetet mbizotërues në Kosovë.³⁷ Ka prova se që prej urdhërimit

³² Vendimi i shtatorit 2010, para 25-28.

³³ Letër e EULEX-it, f. 1.

³⁴ Vendimi i shtatorit 2010, para 29-32.

³⁵ Vendimi i korrikut 2007, para. 20.

³⁶ Vendimi i shtatorit 2010, para 11; Aktgjykimi i Apelit, para. 34.

³⁷ Përgjigje, para 4-5; Vendimi i shtatorit 2010, para 35; *Shih* Përgjigje, Shtojca A, Raport i Komisionit Evropian mbi Përparimin në Kosovë 2010, 9 nëntor 2010, f. 11, 56.

të rigjykimit, dëshmitarët janë ndjerë të kërcënuar.³⁸ Dhoma Gjyqësore ende gjykon se lirimi i përkohshëm i të Akuzuarit do ta kontribuojë në atmosferën kërcënuese ndaj dëshmitarëve dhe mund të inkurajojë përkrahësit e tij të kryejnë akte frikësimi.³⁹ Mirëpo faktori që duhet shqyrtuar këtu është sa thelbësor është rreziku i komprometimit të procesit gjyqësor.

22. Në Vendimin e shtatorit 2010 Dhoma Gjyqësore konkludoi se pasqyrimi më i madh i procesit gjyqësor në media si pasojë e lirimit të përkohshëm të të Akuzuarit menjëherë pas vendimeve të Dhomës së Apelit dhe pak para fillimit të rigjykimit të pjesshëm, do të kishte ndikim më të madh mbi rrethanat, që do të ishin të pafavorshme rëndues për dëshmitarët dhe do të dëmtonin edhe më tepër Dhomën Gjyqësore në përmbushjen e detyrës së saj për të zbuluar të vërtetën.⁴⁰ Që prej Vendimit të shtatorit 2010, rrethanat kanë ndryshuar disi në aspektin se procedura paragjyqësore nuk ka shkuar aq shpejt sa parashikohej, dhe megjithëse pritet që gjykimi të fillojë shpejt, nuk është caktuar asnjë datë për Konferencën Paragjyqësore dhe duhen kryer disa masa procedurale para fillimit të gjyqit. Lirimi i përkohshëm gjatë pushimeve dimërore nuk do të ishte as menjëherë pas vendimeve të Dhomës së Apelit, as pak para fillimit të rigjykimit të pjesshëm. Gjithashtu pasojat prej do të ishin të kufizuara për shkak të kohëzgjatjes relativisht të shkurtër. Dhoma Gjyqësore pranon se vëmendja mbi të Akuzuarin do të shtohet gjatë periudhës zgjedhore ekzistuese e cila mbaron më 12 dhjetor, ditën e zgjedhjeve,⁴¹ d.m.th. para nisjes së periudhës së lirimit të përkohshëm të kërkuar. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore gjykon se ky faktor nuk do të jetë aq i rëndësishëm sa afati dhe kohëzgjatja e lirimit të përkohshëm të të Akuzuarit. Duke marrë parasysh sa më sipër, Dhoma Gjyqësore konkludon se pasoja e mundshme e lirimit të përkohshëm të kërkuar të të Akuzuarit në lidhje me komprometimin e procesit nuk do të ishte thelbësore.

23. Faktor tjetër të cilit Dhoma Gjyqësore i kushtoi rëndësi në Vendimin e shtatorit 2010 ishte kohëzgjatja e paraburgimit si pasojë e ushtrimit të kompetencës për refuzimin e lirimit të përkohshëm.⁴² Konkretisht Dhoma konkludoi se ushtrimi i kompetencës për mosmiratimin e lirimit të përkohshëm do të ishte më pak i justifikueshëm nëse do të kishte

³⁸ Përgjigje, para. 7, Shtojca B.

³⁹ Vendimi i shtatorit 2010, para 36.

⁴⁰ *Po aty.*, para. 40.

⁴¹ Përgjigje, para. 8.

⁴² Vendimi i shtatorit 2010, para 40.

për pasojë zgjatjen e paraburgimit për një periudhë më të gjatë.⁴³ Gjithashtu u konkludua se nëse do të kishte tregues se faza paragjyqësore do të stërzgjatej, kjo do të shkaktonte ndryshimin e rrethanave përkatëse, faktor që Dhoma Gjyqësore do të prirëj ta merrte parasysh.⁴⁴ Dhoma Gjyqësore thekson se i Akuzuari ka qenë në paraburgim që prej 20 korrikut 2010⁴⁵ dhe megjithëse faza paragjyqësore ka përparuar, ende nuk është përcaktuar data e fillimit të gjykimit.

24. Gjithashtu Dhoma Gjyqësore thekson rrethanat personale të të Akuzuarit, veçanërisht në lidhje me bashkëshorten e tij në periudhën e paralindjes dhe në qoftë se është e mundur në lindjen e fëmijës.⁴⁶ Këto rrethana megjithëse nuk duhen shpërfillur, nuk janë të një karakteri urgjent.⁴⁷ Si pasojë atyre u duhet kushtuar rëndësi relativisht e pakët. Këtë rrethana, megjithëse nuk janë të një karakteri urgjent,⁴⁸ dhe si pasojë nuk u duhet kushtuar rëndësi vendimtare, gjithsesi merren parasysh.

25. Dhoma Gjyqësore gjykon se faktorët kritikë në përcaktimin e ushtrimit të kompetencës së saj janë pasoja e mundshme jothelbësore e liritimit të përkohshëm gjatë pushimeve dimërore për komprometimin e procesit gjyqësor për shkak të kohëzgjatjes relativisht të shkurtër, paqartësia në lidhje me datën e fillimit të gjykimit dhe kohëzgjatja e mbajtjes në paraburgim të të Akuzuarit.

26. Pas shqyrtimit të faktorëve përkatës, Dhoma Gjyqësore konkludon se nuk do të ushtrojë kompetencën për refuzimin e liritimit të përkohshëm.

E. VENDIM

Për arsyet e lartpërmendura dhe në përputhje me Rregullat 65 dhe 126 *bis*, Dhoma Gjyqësore:

LEJON të Akuzuarin të paraqesë përgjigje;

⁴³ Vendimi i shtatorit 2010, para 40.

⁴⁴ *Po aty.*, para. 41.

⁴⁵ Mocion, para. 12.

⁴⁶ *Po aty.*, para. 43.

⁴⁷ *Shih* Vendim mbi Mocionin në emër të Ramush Haradinajt për Lirim të Përkohshëm, 20 korrik 2007, para. 21.

⁴⁸ *Shih po aty.*, para. 21.

MIRATON Mocionin; dhe

URDHËRON lirimin e përkohshëm të të Akuzuarit gjatë pushimeve dimërore të gjykatës me kushtet dhe kufizimet e mëposhtme:

- a. I Akuzuari të transportohet nën mbikëqyrje prej autoriteteve holandeze për në aeroportin Schiphol në Holandë, praktikisht sa më shpejt, më 17 dhjetor 2010 ose pas kësaj date;
- b. Në aeroportin Schiphol, I Akuzuari të kalojë nën mbikëqyrjen e oficerit të sigurimit caktuar prej Sekretarit të Tribunalit i cili e shoqëron të Akuzuarin për pjesën tjetër të udhëtimit të tij për në Kosovë;
- c. Në aeroportin e Prishtinës, I Akuzuari t'u dorëzohet përfaqësuesve të Misionit për Kosovën-EULEX, të cilët ta shoqërojnë atë për në vendbanimin e tij;
- d. I Akuzuari t'u japë autoriteteve të Misionit për Kosovën-EULEX dhe Sekretarit të Tribunalit adresën ku do të qëndrojë në Kosovë para se të largohet prej Njesisë së Paraburgimit të Kombeve të Bashkuara në Hagë;
- e. Gjatë periudhës së lirimit të tij të përkohshëm, i Akuzuari t'u përmbahet këtyre kushteve:
 - i. të qëndrojë brenda kufijve të komunës ku banon, Prishtinë;
 - ii. të mos ketë asnjë kontakt ose të mos ndërhyjë në asnjë mënyrë ndaj cilitdo viktime apo dëshmitari të mundshëm ose ndryshe të mos ndërhyjë në procedimin ose ushtrimin e drejtësisë;
 - iii. të mos diskutojë me askënd çështjen e tij, as me median, përveç avokatit të tij;
 - iv. të mos ketë post qeveritar të çfarëdo rangu në Kosovë;
 - v. të mos marrë pjesë në veprimtari politike dhe të mos bëjë deklaratë publike;

- vi. t'u përmbahet përpikmërisht udhëzimeve të autoriteteve të Misionit për Kosovën-EULEX që janë të nevojshme për t'u mundësuar atyre përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas këtij Vendimi dhe garancive të tyre;
 - vii. të vazhdojë bashkëpunimin me Tribunalin dhe të zbatojë përpikmërisht çfarëdo Urdhër tjetër të Dhomës Gjyqësore që ndryshon kushtet e lirit të tij të përkohshëm ose e përfundon atë.
- f. Autoritetet e Misionit për Kosovën-EULEX të garantojnë që:
- i. pas mbërritjes në Kosovë, I Akuzuari t'u dorëzojë pasaportën e tij autoriteteve të Misionit për Kosovën-EULEX;
 - ii. I Akuzuari t'u raportojë çdo dy ditë autoriteteve të Misionit për Kosovën-EULEX në vendbanimin e tij;
 - iii. Dhomës Gjyqësore t'i dërgohet një raport javor në lidhje me lirimin e përkohshëm të të Akuzuarit.
- g. I Akuzuari të kthehet në NJPKB në Hagë jo më vonë se 14 janar 2011, në qoftë se nuk urdhërohet ndryshe prej Dhomës Gjyqësore. Ai të shoqërohet nga vendbanimi i tij në Kosovë prej një zyrtari të Misionit për Kosovën-EULEX i cili t'ia dorëzojë të Akuzuarin oficerit të sigurimit të caktuar prej Sekretarit të Tribunalit. Pas mbërritjes në aeroportin Schiphol, i Akuzuari t'u dorëzohet autoriteteve holandeze, dhe autoritetet holandeze ta transportojnë të Akuzuarin në NJPKB në Hagë.

KËRKON prej Misionit për Kosovën-EULEX të marrë përsipër përgjegjësitë e mëposhtme:

- a. të caktojë një zyrtar të Misionit për Kosovën-EULEX i cili ta shoqërojë të Akuzuarin nga aeroporti i Prishtinës për në vendbanimin e tij dhe t'i informojë sa më shpejt Dhomën Gjyqësore dhe Sekretarin e Tribunalit për emrin e zyrtarit të caktuar;
- b. të tëra shpenzimet në lidhje me transportin e të Akuzuarit prej aeroportit të Prishtinës për në vendbanimin e tij dhe anasjelltas;

- c. me kërkesë të Dhomës Gjyqësore ose të palëve të ndihmojë në lidhje me tëra mjetet dhe format e bashkëpunimit dhe të komunikimit midis palëve dhe të garantojë konfidencialitetin e komunikimit;
- d. t'i raportojë pa vonesë Dhomës Gjyqësore çdo shkelje të kushteve të parashtuara më lart.

UDHËZON Sekretarin e Tribunalit që të këshillohet me Ministrinë e Drejtësisë së Holandës në lidhje me masat praktike për lirimin e të Akuzuarit, të caktojë zyrtarin që do të shoqërojë të Akuzuarin nga aeroporti Schiphol për në aeroportin e Prishtinës dhe anasjelltas dhe të vazhdojë ta mbajë të Akuzuarin në NJPKB në Hagë deri në kohën kur i Akuzuari të ketë dhënë adresën ku do të qëndrojë në Kosovë dhe deri kur Dhoma Gjyqësore dhe Sekretari të jenë informuar për emrin e zyrtarit të caktuar të Misionit për Kosovën-EULEX i cili do ta shoqërojë të Akuzuarin nga aeroporti i Prishtinës për në vendbanimin e të Akuzuarit.

KËRKON prej autoriteteve të të gjitha shteteve nëpërmjet territorit të të cilëve do të udhëtojë Brahimaj:

- a. ta mbajnë të Akuzuarin nën mbikëqyrje gjatë kohës që ai do të jetë në kalim në aeroport; dhe
- b. ta arrestojnë dhe paraburgosin të Akuzuarin deri në kthimin e tij në NJPKB në Hagë nëqoftëse ai orvatet të arratiset.

KËRKON prej Shefit të Misionit për Kosovën-EULEX që të aktivizojë të tëra mjetet dhe burimet e disponueshme për arrestimin e menjëhershëm të të Akuzuarit në rast se ai shkel ndonjë prej kushteve dhe kufizimeve të lartpërmendura të lirimit të tij të përkohshëm.

MIRATON kërkesën e Prokurorisë për pezullimin e zbatimit të vendimit derisa të apelohe.

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

/nënshkruar në origjinal/
Gjykatës Bakone Justice Moloto
Kryegjykatës

Sot, më datën 8 dhjetor 2010.
Në Hagë
Holandë

[Vula e Tribunalit Ndërkombëtar]